



PROCESVERBAL I/2023

I mbajtur me rastin e mbledhjes së I (parë) për vitin 2023 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 23.01.2023
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për intervistimin dhe vlerësimin e kandidatëve që kanë konkurruar në pozitat e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve;**
3. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-16-6343, të datës 28.01.2022;**
4. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për kompensimin e Kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane për tërë territorin e Komunës së Suharekës;**
5. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin “Lulëkuqja me katër petale” të bëhet simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë;**
6. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit financiar i ekzekutimit dhe i administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2022;**
7. **Informatë për aktivitetet e KKS-së, për 6 mujorin e dytë të vitit 2022;**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për intervistimin dhe vlerësimin e kandidatëve që kanë konkurruar në pozitat e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Bulëza Kuçi - pika 1.1 dhe 1.2 a kanë të drejtë vote?

Kryesuesi - po, vetëm 1.4 nuk ka të drejtë vote.

Bulëza Kuçi - përfaqësuesi i prindërve është çdo herë e njëjta. A është mundësia me ndërru ?

Liridon Fandaj - a ka mundësi me na ardhë një material, me një listë të nënshkrimeve dhe procesverbali i cili tregon se e kanë zgjedh këshilli i prindërve atë si përfaqësuese.

Kryesuesi - këtë shqetësim ne do ta adresojmë.

Urim Suka - te pika 1.2 e kemi diskutu edhe atëherë dhe është mirë me ja bashkëngjijt një procesverbal dhe ishin shterru fjalët. Pata dëshirë me qenë drejtori i Arsimit dhe Kryetari dhe me na dhënë sqarimet e nevojshme për këtë pikë. Si po ndihen ata kur në Bllacë është hera e tretë që shpallet konkursi për

zgjedhje të drejtorit ku dhe shumë shkolla tjera janë me ushtrues detyre. Aktualisht që një kohë të gjatë jemi pa drejtor. Ka qenë një ushtruese detyre por është në pushim të lehonisë. Mirëpo nëse e kanë caktu me vendim sekretarin e shkollës, është jo ligjore sepse është ekonomist, edhe pse unë nuk e di.

Liridon Fandaj - Urim, nësi ti punon në atë shkollë dhe deri sa se din që ka ushtrues detyre, pse nuk iu ke drejtu drejtorisë?

Urim Suka - unë këtë çështje e ngrita pasi u diskutu edhe tema e këtij raporti. Drejtori i Arsimit e ka dhënë një intervistë në “Suhareka online” ku ka thënë: deri sa ta zgjedhim një drejtor tjetër, sekretari i shkollës është duke e kryer detyrën. Kjo nuk do të thotë që ai ka lëshu vendim por nëse ai ka marrë vendim, ka bërë shkelje ligjore.

Kryesuesi - sa i përket zgjedhjes së përfaqësuesit të prindërve, ne do ta adresojmë këtë shqetësim tuajin.

Sanie Kuçi Rexhepaj - këtu po shkruan: përditësimi i kandidatëve që kanë konkurruar në pozitat e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve. A është hap konkursi, kanë konkuru dhe ne tash jemi duke e formu komisionin?

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

6 për, 1 apstenim

Miratohet pika 2.

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-16-6343, të datës 28.01.2022;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - ka ardh një projekt-vendim për me ndërru përfaqësuesin e komunitetit katolik. Çka ka ndodh me të? A do të duhej ne me pas një shkresë se çka ka ndodhë sepse mu më le të dyshoj.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë se Mikel Sopa është përfaqësues i komunitetit katolik i cili nuk ka marrë pjesë në takimet e KKSBB-së vitin e kaluar asnjëherë. Udhëzimi administrativ i jep mundësi dhe kompetencë kryesuesit të KKSBB dhe thotë: nëse nuk vje tri herë radhazi në KKSBB, mund të zëvendësohet. Janë listat e pjesëmarrjes së takimeve dhe mund ti shihni.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për kompensimin e Kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane për tërë territorin e Komunës së Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Sanie Kuçi Rexhepaj - a është e caktuar kjo formë e pagesës që nuk mundemi me i ik formës ligjore dhe mundemi me kriju një formë tjetër sepse 300 euro në vit janë pak.

Avni Bytyqi - udhëzimi administrativ jep mundësinë që Kuvendi të nxjerr vendim të veçantë për kompensimin e Kryetarëve të këshillave lokal të fshatrave. Kompenzimi duhet të jetë i barazvlefshëm me anëtarët e komiteteve të përhershme. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

Unanimisht Miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin “Lulëkuqja me katër petale” të bëhet simbol unik për kujtimor i gjenocidit në Kosovë;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Dardan Berisha - realisht në takimin e kaluar kam kërku që të futet kjo pikë sepse 15 janari është caktuar si datë e cila ka me simbolizuar simbolin e Lulëkuqes dhe pasi ju thatë me fut si pikë të rregullt, ne u pajtuam ashtu.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit financiar i ekzekutimit dhe i administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2022;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - kërkoj sqarime nga ZKF. Në krahasim me vitin e kaluar, te projekt-vendimi nuk është e pasqyruar tabela ku tregon se sa janë mbetjet, të hyrat vetanake, suficiti. Pse është largu tabela?

Te sqarimi për pasqyrat përfundimtare është pak e pakuptueshme dhe kërkoj sqarim edhe te mjetet që janë shpenzu me bashkëfinancim dhe për çfarë projekte bëhet fjalë.

Fadil Hoxha - Kur është bërë raporti i zyrës së Kuvendit, unë kam kërku që të lihet për muajin mars gjendja e bartjes për shkak se po kemi problem me thesarin sepse nuk po e dimë gjendjen e saktë. Pra e kemi lënë në fund të muajit mars ta sjellim vendimin në Asamble me tabelat e gjendjes së bartjes.

Urim Suka - a mundemi me miratim një raport ku nuk figuron saktë sa pare kemi me bartë për vitin e ardhshëm?

Fadil Hoxha - po. Zyrtari kryesor financiar jep sqarime.

Urim Suka - ky vendim bie ndesh me vetveten.

Fadil Hoxha - tabelën e kam lënë për mars sepse nuk do të ishte e saktë sepse dhe janari dhe shkurti munden me pas ndryshime. Në KPF nuk është i saktë por kur vje në Asamble si vlerë është e saktë. Zyrtari kryesor financiar tutje jep sqarime.

Kryesuesi - prej kategorisë 10 te Granti Qeveritar suficit janë 150.000, prej denimeve kemi 403.471 euro. Denimet janë të pa planifikuara dhe është buxhet shtesë për neve.

Urim Suka - ju po sjellni dokument të pa saktë. Kur të jet gati le ta sjellin raportin.

600.000 euro janë planifiku për kolektorin e rrugës "Skënderbeu" dhe ky raport që është sjell, shkruan që ato pare janë hargju. Ku kanë shku ato pare? Planifikimi që ke pas, ka dështu. Si mundesh pa planifikim në dy javët e fundit me i hargju?

Fadil Hoxha - për këtë vendos dikush tjetër dhe për mua si kod buxhetor është i shpenzuar dhe është në rregull. Unë mundem me ta nxjerr një gjendje se ku kanë shku ato pare.

Liridon Fandaj - një vendim e kemi marrë në Asamble dhe nëse i kemi bart me një kod buxhetor dikund, është dasht të kthehen prap dhe me i bartë dikund tjetër për me i shpenzu ato pare, e jo tash me marrë vendim Kryetari.

Urim Suka - 6 muaj e ka pas të planifikuar dhe nuk ka qenë në gjendje ti realizoj dhe tash 600.000 euroshin pe shpërndan në 10 projekte.

Liridon Fandaj - te grantet Qeveritare 150.580, a janë mjete që kanë qenë për bujqësi?

Fadil Hoxha - jo, nuk janë.

Liridon Fandaj - cila është arsyeja që këto mjete nuk janë shpenzu?

Fadil Hoxha - nuk kanë sjell fatura që janë bërë shpenzime, punët nuk janë ekzekutu.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

**4 për, 1 kundër, 2 apstenime
Miratohet**

Pika 7. Informatë për aktivitetet e KKS-së, për 6 mujorin e dytë të vitit 2022;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Kryesuesi - pasi nuk ka debat,e hedh në votim pikën 7.

Unanimisht Miratohet

Takimi përfundoi: 14:15

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj